

A K T - T H E M E L U E S

(Kontrate)

I

SHOQERISE

"INFOSOFT SYSTEMS Sh.p.k."

Ne mbeshtetje te ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise,
personat private:

Grigor Joti, qytetar shqiptar, lindur ne Korce me 13.02.1956,
banues ne Tirane, Rr. Myslym Shyri, P.44/1, me numur pasaporte
EV 081674

Gezim Dobi, qytetar shqiptar, lindur ne Gjirokaster, me 09.06.1953,
banues ne Tirane, Rr. Myslym Shyri, Blloku 1 H.12, me numur pasaporte
QH 467391,

si themelues te Shoqerise INFOSOFT SYSTEMS, sot me date 15.12.1995,
duke pasur zotesine ligjore per te vepruar, rane dakord dhe
kontraktuan per sa vijon:

F O R M I M I
Artikulli 1

Formohet Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emer "INFOSOFT
SYSTEMS Sh.p.k.", e cila do te funksionoje sipas ligjeve ne fuqi dhe
Statutit te Shoqerise.
Me poshte do te referohet si Shoqeri.

SELIA
Artikulli 2

Selia e Shoqerise eshte aktualisht ne Rr. Mihal Duri, 17, Tirane.

KOHE ZGJATJA
Artikulli 3

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise eshte e pakufizuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE
Artikulli 4

Objekt i veprimtarise se Shoqerise eshte per sa vijon:

- Importim, eksportim dhe tregetim i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjitha periferikeve te tyre.
- Importim, eksportim dhe tregetim aparaturash te te gjitha llojeve per zyra, pajisje zyrash, e te tjera mjete pune kancelerike duke perfshire edhe te gjitha llojet e letres e materiale te tjera botimi.
- Montim aparaturash te siperpermendura, parametrizim, konfigurim.
- Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te ndryshme te lidhur me Internet-in.
- Zhvillim software, instalim, adoptim. Kurse kualifikimi.



- Mirembajtje te aparaturave te siperpermendura, suport teknik, konsulence gjithfarellojesh.
- Operacione te ndryshme komisionerie.
- Zyre kembimi valutash.
- Veprime kreditimi ose huamarrje sipas kushteve dhe interesave.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE
Artikulli 5

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,000 leke, i formuar si me poshte:

Grigor Joti	60,000 leke	60% e kapitalit
Gezim Dobi	40,000 leke	40% e kapitalit

Artikulli 6

Ndarja e fitimit te Shoqerise midis ortakeve do te jete ne raportet e pjesemarrjes se tyre ne kapitalin e Shoqerise, pra:

Grigor Joti	60% te fitimit
Gezim Dobi	40% te fitimit

Artikulli 7

Per sa nuk percaktohet me siper, i referohet ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Artikulli 8

Ky Akt-Themelues (kontate) perpilohet ne disa kopje, per t'iu shperndare organeve kompetente te permendur ne Statutin e Shoqerise.

Akti-Themelues (kontrata) hyn ne fuqi ditën e firmosjes se tij nga ortaket themelues te Shoqerise.

Kontrata firmoset rregullisht nga ortaket e Shoqerise:

Grigor Joti

Tirane, ne 15.12.1995

Gezim Dobi



**AKT – THEMELIMI
(Kontrate)
I SHOQERISE “INFOSOFT SYSTEMS” SHA**

Sot me date **16/05/2001**, ne mbeshtetje te ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise, personat e meposhtem:

Grigor JOTI, qytetar shqiptar, lindur ne Korce me 13.02.1956, banues ne Tirane, Rr.Hafiz Ibrahim Dalliu, Nr.62, Tirane, me numer pashaporte EV 081674 dhe,
Gezim DOBI, qytetar shqiptar, lindur ne Gjirokaster, me 09.06.1953, banues ne Tirane, Rr.Myslym Shyri, Biloku 1, h.12, me numer pasaporte QH 467391,

ortake te shoqerise INFOSOFT SYSTEMS shpk, u mblodhen ne seline e shoqerise ne adresen Rr.Murat Toptani, Gjergji Center, Tirane, dhe rane dakort per sa vijon:

**Neni 1
FORMIMI**

Krijohet shoqeria InfoSoft Systems SH.A (me poshte do te referohet si Shoqeria) nepermjet shnderrimit te shoqerise InfoSoft Systems shpk ne shoqeri aksionere pa oferte publike, konform ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 “Per shoqerite tregtare”.
Shoqeria e formuar do te funksionoje sipas ligjeve ne fuqi, ketij Akt-Themelimi dhe Statutit te shoqerise.

**Neni 2
SELIA**

Selia e shoqerise do te jete ne: Rr. Murat Toptani, Gjergji Center, Tirane.

**Neni 3
KOHEZGJATJA**

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike te shoqerise eshte e pacaktuar.

**Neni 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

Objekt i veprimtarise se shoqerise eshte per sa vijon:

- Importim, eksportim dhe tregetim i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjitha periferikeve te tyre.
- Importim, eksportim dhe tregetim aparaturash te te gjitha llojeve per zyra, pajisje zyrash, e te tjera mjete pune kancelarike duke perfshire edhe te gjitha llojet e letres e materiale te tjera botimi.
- Montim aparaturash te siperpermendura, parametrizim, konfigurim.
- Sherbime transmetimi te dhenash, infomacione dhe sherbime te ndryshme te lidhur me Internet-in.
- Zhvillim software, instalim, adoptim. Kurse kualifikimi.
- Mirembajtje te aparaturave te siperpermendura, suport teknik, konsulence gjithfarellojesh.
- Operacione te ndryshme komisionere.
- Zyre kembimi valutash.
- Veprime kreditimi ose huamarrje sipas kushteve dhe interesave

dhe pergjithesisht cdo operacion financiar tregtar, sherbimi, industrial, me pasuri te luajteshme ose te paluajteshme qe mund te lidhen drejtperdrejt ose terthorazi me nje nga objektet e siperpermendura.

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 43.000.000 (dyzete e tre milion) leke. Ai eshte i ndare ne 43.000 (dyzete e tre mije) aksione nominative, me vlere nominale 1.000 (nje mije) leke secili te numertuara nga numri 1 (nje) deri ne 43.000 (dyzeteetremije) perfshire. Kontributi i sejcilit prej ortakeve eshte si me poshte:

Grigor JOTI 25.800.000 (njetepesemilioneetetqindmije) leke, ose 60% (gjashtedhjete) e kapitalit, ose 25.800 (njetepesemijeeteteqind) aksione.
Gezim DOBI 17.200.000 (shtatembedhjetemilioneedyqindmije) leke, ose 40% (dyzete) e kapitalit ose 17.200 (shtatembedhjetemijeedyqind) aksione.

Neni 6

Ndarja e fitimit te shoqerise midis ortakeve do te jete ne raportet e pjesmartjes se tyre ne kapitalin e shoqerise, pra:

Grigor JOTI	60% (gjashtedhjete) te fitimit
Gezim DOBI	40% (dyzete) te fitimit.

Neni 7

Per sa nuk percaktohet ne kete akt-themelim, i referohet ligjeve ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Neni 7

ORGANET DREJTUESE

Organet kryesore te shoqerise do te jene:

1. Asambleja e Aksionereve;
2. Keshilli Mbikqyres;
3. Drejtoria.

Perberja e tyre, kompetencat, menyra e organizimit etj, do te percaktohen ne Statutin e shoqerise te miratuar nga ortaket.

Neni 8

Ky Akt-Themelimi hyn ne fuqi pas firmosjes se tij nga ortaket (aksioneret).

Grigor JOTI



Gezim DOBI





STATUT I SHOQERISE "INFOSOFT SYSTEMS" SHA

KREU I DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Neni 1

Forma e shoqerise

Shoqeria do te jete shoqeri anonime, pa oferte publike.
Shnderrimi i saj ne nje forme tjetere do te behet sipas dispozitave te ketij Statuti dhe Ligjit Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare".

Neni 2

Objekti i veprimtarise se Shoqerise

Objekti i veprimtarise se Shoqerise eshte:

- Importim, eksportim dhe tregetim i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjitha periferikeve te tyre.
- Importim, eksportim dhe tregetim aparaturash te te gjitha llojeve per zyra, pajisje zyrash, e te tjera mjete pune kancelarike duke perfshire edhe te gjitha llojet e letres e materiale te tjera botimi.
- Montim aparaturash te siperpermendura, parametrizim, konfigurim.
- Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te ndryshme te lidhur me Internet-in.
- Zhvillim software, instalim, adoptim. Kurse kualifikimi.
- Mirembajtje te aparaturave te siperpermendura, suport teknik, konsulence gjithfarellojesh.
- Operacione te ndryshme komisionere.
- Zyre kembimi valutash.
- Veprime kreditimi ose huamarrje sipas kushteve dhe interesave.

Neni 3

Emertimi i shoqerise

Emertimi i plote i shoqerise eshte "InfoSoft Systems" SHA.

Ne te gjitha aktet dhe dokumentat e nxjerra nga shoqeria, emertimi i shoqerise do te ndiqet menjehere nga fjalet "shoqeri anonime" ose iniciallet "SHA", duke treguar edhe shumen e kapitalit themeltar. Keto shenime dhe emrat e anetareve te drejtorise dhe te Kryetarit te Keshillit Mbikqyres duhet te figurojne ne te gjitha aktet ose dokumentet e shpallura nga shoqeria, te destinuara per te tretet.

Neni 4

Selia

Selia e shoqerise eshte ne: Gjergji Center, Rruga "Murat Toptani", Tirane.

Ajo mund te krijojte filiale, agjensi, zyra perfaqesimi brenda vendit, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, po ashtu edhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin e atij vendi pa cenuar legjislacionin shqiptar.



Neni 5 Kohezgjatja e shoqerise

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise, do te jete pa afat te caktuar. Ndryshimi i afatit, ose prishja e shoqerise, jo sipas parashikimit te mesiperm te ketij neni, behet me vendim te Asamblese se Aksionareve, sipas parashikimeve te legjislacionit ne fuqi per kete qellim.

Neni 6 Kapitali themeltar i shoqerise

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 43.000.000 (dyzete e tre milion) leke. Ai eshte i ndare ne 43.000 (dyzete e tre mije) aksione nominative, me vlere nominale 1.000 (nje mije) leke secili te numertuara nga numri 1 deri ne 43.000 perfshire.

Neni 7 Ndryshimet e kapitalit themeltar

Kapitali themeltar, mund te ndryshohet me te gjitha menytrat dhe modalitetet e kerkuara nga legjislacioni ne fuqi per kete qellim. Ne baze te nenit 152, te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per Shoqerite Tregtare", i vetmi organ kompetent, per te vendosur ndryshimin e kapitalit themeltar, eshte Asambleja e Jashtezakonshme e aksionereve, e cila merr vendime ne baze te raportit te Drejtorise qe permban treguesit e kerkuar nga ligji.


Ne rastin e zmadhimit te kapitalit themeltar me para ne dore, aksioneret e shoqerise, kane nje te drejte paresore ne nenshkrimin e tij, proporcionalisht me shumen e aksioneve qe ata zoterojne dhe me perqindjen qe i perket ne kapitalin e shoqerise. Zmadhimi i kapitalit nepermjet rritjes se vleres nominale te aksioneve behet vetem me pelqimin unanimit te aksionareve, me perjashtim te rastit kur ai realizohet me perfshirjen e rezervave, te fitimeve apo primeve te emetimit. Ata mund te heqin dore nga kjo e drejte, vetem me shkrim, ne mbledhjen e aksionereve ku miratohet ky zmadhim.

KREU II AKSIONET DHE AKSIONERET

Neni 8 Aksioneret e shoqerise

Aksioneret e shoqerise mund te jene persona fizike dhe/ose juridike, qe kane vene ose do te vene ne zoterim aksione te shoqerise, me te gjitha menytrat e parashikuara nga ligji. Pronesia mbi aksionet e shoqerise, permban aderimin me te drejta te plota ne statutin e shoqerise nepermjet perfaqesimit ne asamblene e pergjithshme te aksionereve.

**Neni 9
Te drejtat dhe detyrat e aksionereve**
Cdo aksioner, ka te drejten e pjesmarrjes ne fitimet e shpermdashme te shoqerise, dhe perfiton, proporcionalisht me shumen e aksioneve qe zoteron dhe me perqindjen qe i perket ne kapitalin themeltar te shoqerise.



Cdo aksioner ka te drejte te marre, kur eshte rasti, nje pjese nga teprica e likujdimit te shoqerise ne te njejtin perpjestim sipas paragrafit te pare te ketij neni.

Aksioneret kane te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne Asamblene e Aksionereve ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni ne fuqi dhe ky statut.

Aksioneret jane vete pergjegjes per detyrimet dhe per humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres nominale te aksioneve qe zoterojne, kerkimi i fondeve tej kesaj mase eshte i ndaluar.

Te drejtat dhe detyrimet e permendura me siper ndjekin aksionin ne cfaredo forme qe ai tjetersohet tek te tretet.

Neni 10 Format e aksioneve dhe libri i aksioneve

Me perjashtim te rasteve te trashegimise, transferimi i pronesise mbi aksionet e nje personi te trete, pavaresisht nga baza juridike, duhet ti nenshtrohet pelqimit te shoqerise sipas dispozitave te nenit 207 te ligjit "Per shoqerite tregtare".

Pronesia e aksioneve, rezulton nga regjistrimi i tyre ne emer te titullarit ose titullareve ne librin e aksionereve te mbajtur nga shoqeria, ose nga nje ndermjetes financiar i specializuar, sipas legjislacionit ne fuqi.

Libri i aksionereve do te permbaje ne cdo kohe informatat qe vijojne: numrin dhe kategorine e aksioneve, daten e marrjes nga aksioneri, emrin, mbiemrin dhe adresen e cdo aksioneri si dhe vleren nominale per cdo aksion te zoteruar.

Secili aksioner ka te drejte, te kerkoje dhe ta merre me shkrim nje ekstrat nga libri i aksionereve, me firmen e titullarit dhe vulen e institucionit te ngarkuar per mbajtjen e tij.

Secili aksioner ka te drejte te verifikoje nese emri i tij eshte futur ne librin e aksionereve dhe institucioni qe mban librin, eshte i detyruar t'i tregoje aksionerit, me kerkesen e ketij te fundit, hyrjen perkatese ne liber.

Shoqeria, ose ndermjetesi financiar i specializuar, qe mbajne librin e aksionereve, ka te drejte tu jape aksionereve te saj, certifikata pronesie te aksioneve, me firmen e titullarit dhe vulen e institucionit.

Aksionet e shoqerise, jane te transferueshme me rruge trashegimie, ne perputhje me dispozitat e Kodit Civil per trashegimine.

Neni 11 Shitja dhe transferimi i aksioneve

Ne rastin e zmadhimit te kapitalit, aksionet jane te tregtueshme, pas regjistrimit te ketij ndryshimi. Pas prishjes (likujdimit) te shoqerise, aksionet mbeten lirisht te tregtueshme, deri ne mbylljen e likujdimit, sipas dispozitave ligjore ne fuqi.



Neni 12
Shlyerja e aksioneve

Aksionet e nenshkruara per kontributin ne para, lidhur me zmadhimin e kapitalit te shoqerise, duhet te shlyhen, sipas modaliteteve te caktuara nga mbledhja e Asamblese se Jashtezakonshme te aksionereve, por shlyerja e ketyre, detyrimisht, gjate nenshkrimin, nuk mund te jete me e ulet se sa 1/4 (nje e katerta) e vleres nominale dhe ne se eshte nevoja me teresine e primeve te emisionit. Kur aksioneri, per shumate e mbetura per tu shlyer mbi vleren e aksioneve te nenshkruara prej tij, nuk i kryen ne afatet e percaktuara nga Drejtoria, shoqeria procedon sipas kerkesave te ligjit, deri ne shitjen e ketyre aksioneve pa asnje autorizim gjyqesor. Cdo vonese ne derdhjen e shumave te duhura nga shumate e pashlyera te aksioneve, sjell pagimin e interesave, me perqindjet ligjore dhe kjo pavaresisht nga veprimet personale qe shoqeria mund te ushtroje ndaj aksionerit, qe nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit te detyruar te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi per kete ceshtje.

KREU III
ORGANET DREJTUESE TE SHOQERISE

Neni 13
Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane:

1. Asambleja e Aksionareve;
2. Keshilli Mbikqyres;
3. Drejtoria.

Neni 14
Asambleja e Aksionereve

Asambleja e Aksionereve, qofte e zakonshme ose e jashtezakonshme, ka kompetenca dhe merr te gjitha vendimet te percaktuara nga ligji "Per shoqerite Tregtare" ose nga statuti.

Asambleja e aksionereve do te mbahet ne zyren e regjistruar te shoqerise, ose ne nje vend tjeter te caktuar me pare ne lajmerimin per mbledhje.

Te drejten e thirrjes se asamblese e kane, Keshilli Mbikqyres ose Drejtori, ne mungese ajo mund te thirret edhe nga personat e parashikuar ne ligj.

Neni 15
E drejta e votes

E drejta e votes qe rrjedh nga zoterimi i aksioneve, eshte proporcional me pjesen e kapitalit qe ato perfaqesojne dhe cdo aksioner jep te drejten e te pakten nje vote.

E drejta e votes qe rrjedh nga perfaqesimi, kerkon nje mandat perfaqesimi, te shkruar, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.





Neni 16 Drejtimi i asamblese

Thirrja e mbledhjes se Asamblese se Aksionereve behet nepermjet njoftimit te derguar me leter rekomande ne adresen e cdo aksioneri me shpenzimet e shoqerise.

Mbledhjet e Asamblese se Aksionereve, drejtohen nga Kryetari i Keshillit Mbikqyres ose ne mungese te tij, mbledhjen e drejton nje kryetar i caktuar nga asambleja.

Gjithashtu mbledhjen e asamblese mund ta drejtojne autoret e thirrjes se saj sipas kerkesave te ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

Kryetari drejton mbledhjen e asamblese dhe vendos mbi vazhdimesine, objektet e bisedimit dhe mbi menyren e votimit.

Kryetari cakton nje sekretar per te mbajtur procesverbalet e ceshtjeve te shqyrtuara.

Neni 17 Procesverbalet e mbledhjes se Asamblese

Procesverbalet e mbledhjes se Asamblese, duhet te mbahen ne perputhje me kerkesat e Ligjit "Per Shoqerite Tregtare" dhe detyrimisht ne fund te saj, duhet te firmosen ne cdo rast nga kryetari dhe sekretari.

Asambleja e Jashtezakonshme mund te marre vendime te vlefshme vetem ne rast se aksioneret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne ne mbledhjen e pare te pakten $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe ne te dyten $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Ne mungese te ketij quorumi mbledhja e dyte e asamblese mund te shtyhet per nje date te mevoneshme, jo me te larget se dy muaj nga data e thirrjes se pare. Ajo merr vendim me nje shumice votash prej $\frac{3}{4}$ qe u perkasin aksionareve te pranishem ose te perfaqesuar.

Asambleja e Zakonshme merr vendime te vlefshme ne mbledhjen e pare, vetem ne qofte se aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar zoterojne te pakten $\frac{1}{4}$ e aksioneve me te drejte vote. Ne rast se kjo mbledhje nuk realizohet, ne te dyten nuk kerkohet asnje lloj quorumi.

Asambleja e zakonshme merr vendim me shumicen e votave qe zoterojne aksionaret e pranishem ose te perfaqesuar.

Neni 18 E drejta per tu njohur me dokumentat

Drejtoria e shoqerise, duhet te pakten 15 dite para dates se mbledhjes se asamblese t'u dergoje, ose t'u vere ne dispozicion aksionereve, dokumentet e nevojshme per t'u njohur dhe per te dhene nje gjykim te plote, mbi administrimin dhe ecurine e puneve te shoqerise, si: bilancet financiare te fund-vitit, raportin mbi aktivitetin e shoqerise, raportin e ekspertit kontabel te autorizuar, raportin e Keshillit Mbikqyres, te gjitha projekt-vendimet dhe projekt-rezolutat si dhe te gjitha dokumentat e tjera te parashikuara ne ligjin "Per shoqerite Tregtare".

KESHILLI MBIKQYRES

Neni 19 Perberja

Keshilli Mbikqyres perbehet nga tre anetare. $\frac{2}{3}$ e anetareve te tij zgjidhet nga Asambleja themeluese ose ajo e Zakonshme e aksionereve duke respektuar kufizimet qe parashikohen ne ligj. $\frac{1}{3}$ e anetareve te Keshillit Mbikqyres zgjidhet nga te punesuarit ne shoqeri.

Koha e ushtrimit të detyrës për të gjithë anëtarët është 6 vjet me të drejtë rizgjedhje, ndërsa për anëtarët e caktuar në statut ajo është 3 vjet.

Keshilli Mbikqyres, zgjedh midis anëtareve të tij, një kryetar dhe një zëvendës.

Anëtarët e keshillit mbikqyres, mund të japin dorëheqjen nga detyra, me anë të një deklaratë me shkrim, e cila duhet t'i dërgohet kryetarit të keshillit mbikqyres, duke respektuar një limit kohe prej dy javësh. Shkarkimi dhe zëvendësimi i tyre bëhet në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

Neni 20 Autoriteti

Deklaratat e Keshillit Mbikqyres, do të jepen në emër të këtij keshilli, vetëm nga kryetari dhe në mungesë të tij nga zëvendës kryetari.

Neni 21 Procesverbalet e mbledhjes së Keshillit Mbikqyres

Procesverbalet e mbledhjeve të Keshillit Mbikqyres, për çështjet e shqyrtuara dhe për vendimet e marra, duhet të nënshkruhen nga kryetari i këtij keshilli dhe në mungesë të tij nga zëvendësi.

Neni 22 Detyrimi për fshehtësi

Anëtarët e Drejtorisë dhe të Keshillit Mbikqyres, si dhe çdo person që thirret të marrë pjesë në mbledhjet e këtyre organeve, duhet të ruajë fshehtësinë për informacionin konfidencial dhe sekretet e shoqërisë, veçanërisht ato industriale dhe të biznesit, për të cilat ato janë bërë të vetdijshëm nëpërmjet punës së tyre. Kjo mbetet e vlefshme dhe pas largimit nga funksionet që kanë ushtruar.

Informacioni lidhur me shoqërinë mund të transferohet paleve të treta, vetëm me miratimin e Kryetarit të Keshillit Mbikqyres dhe me kusht që transferimi nuk rrezikon interesat e shoqërisë.

Neni 23 Thirrja dhe drejtimi

Mbledhjet e keshillit mbikqyres, thirren me shkrim nga kryetari dhe në mungesë, nga zëvendësi i tij. Lajmerimi bëhet 15 ditë përpara. Në raste urgjente lajmerimi mund të bëhet brenda një kohe me të shkurter dhe ftesa mund të komunikohet gojarisht, me telefon, fax, teleks ose telegram në ftesë duhet të specifikohen rendi i ditës dhe sugjerimet e vendimeve.

Ndonjë anëtar i keshillit mbikqyres, mund të shtroje çështje në rendin e ditës, të cilat duhet t'i behen të njohura kryetarit me anë të një letre, të pakten 10 ditë para mbledhjes. Të gjithë anëtarët e tjere të keshillit duhet të informohen pa vonesë mbi shtesat e rendit të ditës. Vlefshmeria e mbledhjeve të keshillit mbikqyres dhe e vendimeve të marra prej tij përcaktohet në bazë të kërkesave të ligjit "Për shoqëritë tregtare".





Neni 24 Kompetencat

Keshilli mbikqyres, ushtron kontroll te vazhdueshem ndaj drejtorise, per menyren e administrimit te shoqerise nga ana e saj.

Drejtoria, i paraqet raport keshillit mbikqyres, te pakten nje here ne tre muaj, mbi punet e shoqerise, si dhe i ve ne dispozicion brenda tre muajve mbas mbylljes se vitit financiar, te gjitha dokumentat e percaktuara ne ligj, qe do te shqyrtohen ne mbledhjen e asamblese, me qellim verifikimi dhe kontrolli.

Keshilli mbikqyres, se bashku, ose duke autorizuar anetare te tij, sipas nje programi te miratuar me pare ne mbledhjen e tij, ka te drejte, te kryeje ne cdo kohe verifikimet dhe kontrollet qe ai i gjykon te arsyeshme dhe te kerkoje te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme, per plotesimin e detyres se tij.

Keshilli mbikqyres, ka te drejte kur e gjykon te arsyeshme te kerkoje nje raport per punet e shoqerise, marredheniet ligjore dhe te biznesit me shoqerite qe kane lidhje, si edhe per aktivitete te biznesit qe konsiderohen te rendesishme per interesat e aksionereve.

Keshilli mbikqyres, eshte pergjegjes per mbrojtjen e te drejtave te shoqerise te cilat i jane ngarkuar atij me ane te ligjit, statutit ose ne ndonje forme tjeter.

Keshilli mbikqyres ka gjithashtu te drejten te therrase asamblene e aksionareve.

Keshilli mbikqyres, mund te percaktoje nje liste te atyre masave dhe veprimeve te cilat mund te merren nga Drejtoria e shoqerise. Keto i nenshtrohen marreveshjes fillestare te keshillit mbikqyres. Kjo eshte e vlefshme vecanerisht, per politiken e objekteve te biznesit, investimit dhe financimit, fushat e veprimit te shoqerise dhe personelit, dhe drejtimin e kontrates.

Neni 25 Quorumi

Keshilli Mbikqyres nuk mund te marre vendime te vlefshme, pa qene e pranishme te pakten $\frac{1}{2}$ e anetareve te tij.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem ose te perfaqesuesve te tyre.

Vota e Kryetarit eshte percaktuese ne rast rezultati te barabarte votash.

Neni 26 Shperblimi

Asambleja mund tu caktoj anetareve te Keshillit Mbikqyres si shperblim nje shume vjetore fikse per pjesmarrjen e tyre ne seancat e ketij keshilli. Shperblimi i anetareve te keshillit perballohet nga llogaria e shoqerise.

Keshilli Mbikqyres mund te caktoj shperblime te jashtezakonshme per sherbimet apo detyrat qe u besohen anetareve te keshillit. Keto shperblime perballohen nga llogaria e shoqerise dhe u nenshtrohen rregullave te neneve 122-125 te ligjit "Per shoqerite tregtare".



DREJTORIA E SHOQERISE

Neni 27 Perberja

Drejtoria e shoqerise do te perbehet nga nje person fizik i cili emerohet nga mbledhja e Keshillit Mbikqyres per nje periudhe 6 vjecare dhe qe ushtron funksionet e tij nen kontrollin e ketij keshilli. Anetaret e Drejtorise mund te shkarkohen per shkaqe te perligjura nga Keshilli Mbikqyres. Si shkaqe te perligjura konsiderohen vecanerisht nje faj i rende i anetarit te Drejtorise, paaftesia e tij ne kryerjen korrekt te funksioneve ose kur asambleja humbet besimin tek ai.

Neni 28 Kompetencat dhe kufizimet

Drejtori, ka kompetenca te plota per te vepruar ne cdo rrethane ne emer te shoqerise, kompetenca qe i ushtron brenda objektit te veprimtarise se saj.

Drejtori eshte i detyruar para shoqerise te respektojte kufizimet e percaktuara me ligj, nga statuti dhe Keshilli Mbikqyres, lidhur me hapesiren e autoritetit te tij menaxhues.

Neni 29 Veprime qe kerkojne autorizim paraprak

Drejtori i shoqerise, nuk mund te kryeje pa miratimin e Keshillit Mbikqyres vendosjen si garanci per detyrimet e ndryshme, pasurine e paluajteshme te shoqerise.

Neni 30 Perfaqesimi

Nga ana ligjore shoqeria perfaqesohet ne te tretet, nga Drejtori i saj.

Neni 31 Ekspertet Kontabel te autorizuar

Shoqeria ne mbledhjen e zakonshme te Asamblese, emeron dy eksperte kontabel te autorizuar dhe dy zevendesues, te cilet emerohen per nje vit fiskal, duke respektuar modalitetet dhe kufizimet e parashikuara ne ligjin "Per Shoqerite Tregtare".

Veprimtaria e tyre do te zhvillohet ne perputhje me ligjin e mesiperm.

Shperblimi, do te percaktohet me nje marreveshje midis tyre, Keshillit Mbikqyres dhe Drejtorit te shoqerise, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Neni 32 Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin periudhen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.



Neni 33
Ndarja, bashkimi dhe likujdimi i shoqerise

Shoqeria mund te shkrihet, te likujdohet ose te transformohet ne nje forme tjeter, perpara afatit te percaktuar, me vendim te asamblese se jashtezakonshme te aksionereve, ne perputhje me parashikimet e ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

Neni 34
Anetaret e pare te Keshillit Mbikqyres

Emerohen si anetare te pare te Keshillit Mbikqyres:

1. Gezim DOBI
2. Roland JOTI
3. Caci SIMEONI

te cilet kane bere te ditur qe pranojne funksionet respektive dhe pohojne se nuk jane te prekur nga asnje papajtueshmeri apo ndalim qe pengon emerimin e tyre.

Neni 35
Ekspertet e pare Kontabel te Autorizuar

Emerohen si Eksperte Kontabel te Autorizuar:

1. Z. Theodhoraq GJOSHA;
2. Z. Sabri PALAMANI

dhe zevendes te tyre,


1. Z. Dashnor MEMISHI
2. Z. Nikolla GECO

Neni 36
Dispozita te pergjithshme

Per te gjitha ato ceshtje, te cilat nuk jane parashikuar ne kete statut, do te zbatohet ligji Nr.7638, dt.19/11/1992 "Per Shoqerite Tregtare".

Tirane, me 16.05.2001

Grigor JOTI



Gezim DOBI



STATUTI



I

SHOQERISE TREGETARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"INFOSOFT SYSTEMS Sh.p.k."

FORMIMI Artikulli 1

Formohet Shoqeria me emertimin "INFOSOFT SYSTEMS Sh.p.k." si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar e pronareve themelues :

Grigor Joti, qytetar shqiptar, lindur ne Korce me 13.02.1956, banues ne Tirane, Rr. Myslym Shyri, P.44/1, me numur pasaporte EV 081674,

Gezim Dobi, qytetar shqiptar, lindur ne Gjirokaster, me 09.06.1953, banues ne Tirane, Rr. Myslym Shyri, Blloku 1, H.12, me numur pasaporte QH 467391,

sipas Aktit Themelues (kontrates) te lidhur midis tyre, ne daten e sotme, 15.12.1995, si dhe ne perputhje me ligjet ne fuqi te Republikes se Shqiperise per shoqerite tregtare dhe ligjet e tjera.

EMERTIMI I I SHOQERISE Artikulli 2

Emertimi i Shoqerise : "INFOSOFT SYSTEMS Sh.p.k."
Me poshte do te referohet si Shoqeri.

SELIA Artikulli 3

Selia e Shoqerise eshte aktualisht ne Rr. Mihal Duri, 17, Tirane. Shoqeria mund te krijoje filiale, perfaqesi e dege edhe ne rrethet e tjera te vendit ose jashte shtetit.

KOHE ZGJATJA Artikulli 4

Kohezgjatja e veprimtarise ekonomike e Shoqerise eshte e pakufizuar.

OBJEKTI I VEPRIMTARISE Artikulli 5

Objekt i veprimtarise se Shoqerise eshte per sa vijon:

- Importim, eksportim dhe tregetim i sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjitha periferikeve te tyre.
- Importim, eksportim dhe tregetim aparaturash te te gjitha llojeve per zyra, pajisje zyresh, e te tjera mjete pune kancelerike duke perfshire edhe te gjitha llojet e letres e materiale te tjera botimi.
- Montim aparaturash te siperpermendura, parametrizim, konfigurim.
- Sherbime transmetimi te dhenash, informacione dhe sherbime te ndryshme te lidhur me Internet-in.



- Zhvillim software, instalim, adoptim. Kurse kualifikimi.
- Mirembajtje te aparaturave te siperpermendura, suport teknik, konsulence gjithfarellojesh.
- Operacione te ndryshme komisionerie.
- Zyre kembimi valutash.
- Veprime kreditimi ose huamarrje sipas kushteve dhe interesave.

KAPITALI THEMELTAR I SHOQERISE

Artikulli 6

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100,000 leke, i formuar sipas kriterëve te percaktuara ne Aktin Themelues (kontrates) te kesaj Shoqerie.

DREJTIMI

Artikulli 7

Shoqeria drejtohet nga Asambleja e Shoqerise e cila perbehet prej ortakeve themelues te Shoqerise.
Secili ortak ka te drejte vote sipas perqindjes se secilit ne kuotat e kapitalit themelor te Shoqerise.

Artikulli 8

Asambleja zgjedh Administratorin e Pergjithshem, i cili drejton veprimtarine e Shoqerise ndermjet dy mbledhjeve te Asamblese duke zbatuar vendimet e saj.
Administrator i Pergjithshem zgjidhet ortaku Grigor Joti.
Kompetencat e Administratorit te pergjithshem jane ato qe percaktohen ne ligjin per shoqerite me pergjegjesi te kufizuar.

TRASHEGIMIA

Artikulli 9

Ne rast vdekjeje te ndonjerit prej ortakeve ose paaftesise fizike ose mendore, gje qe shkakton pamundesine e tij per pune, ai ose trashegimtaret e ligjshem te tij lejohen te trashegojne dhe mbajne deri ne 25% te kuotes se ortakut te siperpermendur. Pjesa tjeter prej 75% u kthehet ne forme likuidimi brenda 1 viti, sipas vendimit te Asamblese.
Ortaket e tjere aktive te Shoqerise ndajne kuoten diference ne menyre proporcionale me kuotat e tyre.

NDALIMET

Artikulli 10

Ortakeve u ndalohet te jene ortake, punonjes apo te kontribuojne ne cfaredo lloj forme ne ndonje Shoqeri tjeter, aktiviteti i te ciles konsiderohet nga Asambleja direkt ose indirekt si konkurent me Shoqerine.

Artikulli 11

Ortaket e Shoqerise, gjate kohes qe jane te tille, por edhe pas largimit nga Shoqeria, jane te detyruar te ruajne informacionet konfidenciale te Shoqerise.



Artikulli 12

Neqoftese nje ortak largohet nga Shoqeria, Asambleja mund t'i kerkoje atij ndalimin deri 1 vit te cdo lloj veprimtarie profesionale ne fusha konkurente me ato te Shoqerise, qofte kjo veprimtari direkte apo indirekte. Ne kete rast, ortakut te larguar dhe te ndaluar, i paguhet gjate periudhes se ndalimit rroga mesatare gjate vitit te fundit te tij ne Shoqeri.

Artikulli 13

Shkelja e vertetuar e ndonjerit prej kushteve te Ndalimit shkakton:

- Largimin e ortakut nga Shoqeria,
- Penalitet financiar sipas vendimit te Asamblese, neqoftese ortakut ka akoma marredhenie financiare me Shoqerine,
- Penalitete gjyqesore, sipas vendimit te gjykates per demin e shkaktuar Shoqerise.

DISPOZITA TE FUNDIT Artikulli 14

Mosmarreveshjet qe nuk zgjidhen ne mirekuptim gjykohen ne gjykatën e rrethit Tirane.

Artikulli 15

Per sa nuk eshte percaktuar ne kete statut, i referohet ligjeve ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

Artikulli 16

Shoqeria fillon ushtrimin e aktivitetit te saj nga dita e regjistrimit dhe dhenies se lejes nga zyra e tatimeve e rajonit numer __ Tirane.

Artikulli 17

Ky Statut perpilohet ne disa kopje, per t'iu shperndare organeve perkatese:

- Gjykates se Rrethit te Tiranes per te bere veprimet ne Regjistrin tregtar dhe njohjen si person juridik te kesaj Shoqerie.
- Sektorit te Tatimeve nr. 2 te Tiranes per te bere regjistrimin e Shoqerise si subjekt privat dhe marrjen e lejes ushtrimit te veprimtarise.
- Nje kopje mbetet si pjese e dokumentacionit te themelimit te Shoqerise

Statuti hyn ne fuqi ditën e Shpalljes se tij, i firmosur rregullisht nga ortakët themelues te Shoqerise :

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

Grigor Joti

Tirane, me 15.12.1995

Gezim Dobi